
RECENSIONE

ALBANA MEMA: INSTITUCIONET PËRFAQËSUESE NË SHQIPËRI (1920-1924), Tiranë: Kristalina-KH, 2021, 484 f.

Monografia “Institucionet përfaqësuese në Shqipëri (1920-1924)”, trajton tërësinë e institucioneve përfaqësuese të shtetit shqiptar në periudhën e marrë në studim. Çështje të caktuara të kësaj teme janë trajtuar më parë nga autorë vendës dhe të huaj, por studimi i tyre është bërë në këndvështrime të ndryshme, shpeshherë edhe me analiza klasore e ideologjike, e për rrjedhojë përfundimet e nxjerra prej tyre do të ishin të mangëta dhe larg së vërtetës historike. Analiza e formimit dhe e funksionimit të institucioneve në këtë studim është bërë në përputhje me kuadrin historik të kohës, në lidhje të ngushtë edhe me zhvillimet politike, ekonomike, fetare, arsimore etj.

Struktura e ndërtimit të këtij studimi, i cili për nga natyra e tij është mjaft i vështirë, është ndërtuar drejt, duke vënë në qendër institucionet kryesore të shtetit dhe evoluimin e tyre kronologjik. Autorja ka arritur të shmangë me kujdes përsëritjet që rrezikonin të mbushnin studimin nga një strukturë e tillë që imponohet prej temës së tij, duke bërë disa shkurtime e ripozicionime faktesh e ngjarjesh sipas gravitetit të tyre më të madh në raport me problematikën e institucioneve të ndryshme.

Gjuha dhe stili i shkrimit janë shumë të mira dhe ai lexohet me ëndje dhe lehtësi.

Hulumtimet e shumta që ka bërë autorja në arkivat kryesorë në vend dhe studimi i një literature të gjerë, i kanë dhënë mundësinë të bëjë një trajtim të thelluar për të gjitha çështjet e kësaj teme. Gjithashtu është studiuar edhe një gamë e madhe e dokumentacionit të gjendur në arkivat digjitale të Institutit të Historisë: *The British National Archives (TNA)*, Foreign Office (FO), London dhe *Archivio Storico Diplomatico, Ministero degli Affari Esteri (ASD MAE)*, Roma, Serie Politica (1919-1930), Albania. Këta arkiva jo vetëm që e kanë pasuruar më tej studimin, por i kanë dhënë atij një tjetër dimension, duke e pajisur me informacione dhe analiza të diplomatëve të huaj, italianë e britanikë. Konsultimi i këtyre arkivave ka sjellë risi në analizat e bëra për institucionet dhe elitën

politike që ka vepruar në këtë periudhë. Burimet dokumentare me origjinë të huaj sjellin fakte të reja historike dhe mbështesin teza të reja të pathëna më parë.

Autorja ka shfrytëzuar me përparësi literaturën më të re historike dhe veçanërisht atë të autorëve perëndimorë, e cila nuk ishte analizuar sa duhet më parë në këtë plan. Ajo ka marrë prej saj thelbin e metodologjisë shkencore të tyre dhe këtë e ka aplikuar në studim, duke e rianalizuar këtë periudhë dhe institucionet politike të saj sipas burimeve arkivore shqiptare dhe të huaja që ajo ka qëmtuar nëpër arkiva.

Kështu kjo metodologji, e cila në studimet tona të mëparshme është aplikuar në mënyrë më sipërfaqësore, e ka ndihmuar atë ta shtrijë analizën në caqe të paarrira më parë dhe na ka dhënë një tablo të re, të qëndrueshme e bindëse të jetës politike dhe të institucioneve përfaqësuese të shtetit shqiptar në këtë kohë. Në thelb të studimit është analiza në bazë të parimeve legale të funksionimit të institucioneve. Ajo është konsekuente për të gjitha ngjarjet, institucionet dhe aktorët politikë. Është e qartë, e thellë dhe bindëse, prandaj edhe përfundimet janë mjaft autentike e të arrira. Kjo i jep një vlerë të veçantë studimit.

Lufta e ashpër për pushtet në vitet 1920-1924 u shoqërua me zhvillime të ndryshme e të vullshme të ngjarjeve politike e historike, të cilat autorja i ka shtjelluar gjerësisht, duke i analizuar në shërbim të objektivit kryesor të saj, në rolin që ato luajtën në formimin dhe funksionimin e institucioneve të shtetit.

Krahasuar me institucionet që kishin vepruar deri në këtë kohë në Shqipëri, autorja evidenton veçoritë e institucioneve të shtetit të ngritura rishtazi me Kongresin e Lushnjës, i cili për herë të parë do të përfaqësonte popullin dhe do të ishte i pavarur nga Fuqitë e Mëdha dhe shtetet fqinje.

Kongresi i Lushnjës shënoi një arritje të madhe në procesin e sendërtimit të institucioneve të pastra kombëtare, por sfidat e mëtejshme të tyre ishin të mëdha. Edhe gjatë periudhës që vijoi, situata politike, ekonomike dhe sociale do të ishte e rëndë dhe nuk do të favorizonte konsolidimin e institucioneve kombëtare. Shqiptarëve iu desh që të përballeshin me shumë vështirësi dhe t'i ndërtonin këto institucione, të cilat në disa drejtime do të ishin të suksesshme dhe në disa parametra të tjera do të mbartnin defekte serioze. Analiza e këtyre institucioneve, e natyrës, performancës, funksionimit dhe ndikimit që ato patën në shoqërinë shqiptare është analizuar me saktësi në këtë monografi.

Autorja vlerëson qartë se demokracia parlamentare, aq e vlerësuar në këtë kohë dhe pas saj, madje edhe në ditët tona, do të ishte forma më ideale dhe më e admirueshme, nëse vërtet vendi do t'i kishte gjithë ato prerogativa themelore dhe të qenësishme për një qeverisje të tillë. Por kushtet që kishte vendi ishin thuajse tërësisht jokincurajuese për një qeverisje të mirëfilltë demokratike dhe kjo do të rezultonte me pasoja të rënda negative për zhvillimin e vendit, stabilitetin e tij dhe paqen sociale të brendshme, si dhe do të përbënte një kërcënim për pozitën ndërkombëtare të tij.

Kështu, sistemi parlamentar pluripartiak, do të provohej se nuk ishte forma më adekuate e qeverisjes për shtetin shqiptar. Por, përzgjedhja e këtij sistemi, ishte mundësia e vetme që kishin udhëheqësit e politikës shqiptare në atë kohë, për të rregulluar raportet ndërmjet tyre dhe pushtetit. Pra, sipas autores, ky ishte një kompromis politik i imponuar, që klanet e ndryshme të vijonin konkurrencën për pushtet, pa pasur sa duhet parasysh mundësitë e tyre për të stabilizuar shtetin dhe për të siguruar zhvillimin paqësor të vendit, përmes kësaj forme të regjimit politik.

Autorja me të drejtë arrin në përfundimin se procesi i krijimit dhe i stabilizimit të institucioneve kombëtare përfaqësuese varej shumë edhe nga karakteristikat dhe profili kulturor, politik, social etj., i klasës së re politike shqiptare dhe në radhë të parë të krerëve më të fuqishëm të vendit. Sipas saj, institucionet qeverisëse të kohës duhej të ishin institucione të mirorganizuara, të destinuara për të sjellë stabilitet dhe zhvillim të qëndrueshëm në vend. Por përbërja e tyre nga elementë me nivel të ulët të përgjegjshmërisë politike e shtetformuese, që kishin si qëllim kryesor interesat dhe përfitimet personale e klanore, në raport me nevojën për stabilizimin e shtetit dhe të institucioneve kombëtare, solli krizë brenda këtyre institucioneve dhe mungesë efektiviteti në veprimtarinë e tyre.

Një hapësirë të madhe në studim zë analiza e krijimit dhe e funksionimit të institucioneve kryesore qeverisëse parlamentare, pushtetit legjislativ. Interes të veçantë paraqet edhe studimi i institucionit të opozitës, i cili do të krijohej në gjirin e organeve përfaqësuese, siç janë Parlamenti ose Senati, një karakteristikë themelore dhe funksionale e të gjitha regjimeve parlamentare. Në vitin 1920 jemi ende në fillimin e krijimit të një sistemi politik partiak modern në Shqipëri. Por, autorja me të drejtë konkludon se, problematik për Shqipërinë ishte fakti se këto

grupime nuk ishin krijuar si rezultat i shtresëzimeve politike brenda vendit, por ishin grupe të ndërtuara mbi bazën e përkatësive krahinore, pra lokaliste dhe aq më keq të lidhjeve personale, duke i ballafaquar që në fillim institucionet e shtetit shqiptar me problemin e nepotizmit, lokalizmit dhe klanizmit, me gjithë pasojat e rrezikshme që kishte ai për sendërtimin e institucioneve të shëndosha kombëtare.

Autorja del në përfundimin se, në fillim të viteve '20, gjendja e institucioneve përfaqësuese ishte mjaft fluide dhe se niveli i përgjegjshmërisë politike e shtetformuese të elitës politike shqiptare ishte i ulët. Mungesa e një kuptimi të thellë për politikën dhe institucionet kombëtare, paaftësia për të ndërtuar konsensusin politik, mungesa e perspektivës për zhvillimin e vendit dhe paaftësia për të kuptuar nevojën për stabilizimin e shtetit dhe institucioneve kombëtare, në atë fazë tepër të vështirë të zhvillimit të vendit, dominimi i egoizmit individual mbi parimet e ndërtimit dhe funksionimit ligjor të institucioneve etj., ishin tipare të rëndësishme negative të elitës politike të kohës.

Kjo monografi ka vlera të shumta dhe origjinale. Ajo bazohet në një analizë të saktë dhe të thelluar, duke nxjerrë përfundime të sakta dhe shpeshherë edhe në kundërshtim me pikëpamjet e historiografisë së mëparshme. Ngjarjet dhe personalitetet historike janë gjykuar dhe vlerësuar në raport me parimet e sistemit politik që ishte vendosur, me dispozitat ligjore të kohës dhe me nevojën prioritare për konsolidimin e shtetit. Për këtë arsye ajo përbën një kontribut të rëndësishëm në fushën e historisë së shtetit shqiptar në këtë periudhë.

Akademik Beqir META